



AKTI I THEMELIMI
PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
STUDIO LIGJORE “JURIS D & S” SH.P.K

EMRI I SHOQËRISË

Emri i shoqërisë është STUDIO LIGJORE “JURIS D & S” shpk

SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë është në Tiranë, Njësia Administrative Nr.9, Rruga Haxhi Hysen Dalli, Ndërtesa Nr.89, Hyrja 19, Kodi Postar 1016 ngjitur me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Studio do të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

AFATI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj dhe vepron si person juridik me personalitet të plotë për të vepruar për një kohë të pacaktuar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Studio ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me nenin 2 e vijues të Ligjit Nr. 9109, datë 17.07.2003 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Studio ligjore jep ndihmën juridike nëpërmjet:

- ✚ Këshillimit ligjor për çështje të ndryshme.

- ✚ Përgatitjes së kërkesë padive ose kërkesave gjatë procedimit penal, si dhe të kërkesave ankimore, rekurseve kundër vendimeve gjyqësore, atyre të organit të prokurorisë, arbitrazhit ose të organeve të administratës publike.
- ✚ Përgatitjes së kërkesave drejtuar Gjykatave të Rretheve Gjyqësore, Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë, Gjykatës së Apelit dhe Gjykates Apelit Administrativ, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Gjykatave Ndërkombëtare dhe çdo organi në të cilën aderon Republika e Shqipërisë.
- ✚ Përgatitjes së ankesave dhe kërkesave të personave fizik ose juridik, publik ose privat, vendas ose të huaj.
- ✚ Përpilimit të akteve që i nënshtrohen veprimeve noteriale, të tilla si deklarata apo kontrata.
- ✚ Hartimit të kontratave e marrëveshjeve, si dhe të çdo dokumenti tjetër që sjell ose synon të sjellë pasoja juridike.
- ✚ Pranisë si mbrojtës në kohën e shoqërimit, ndalimit, arrestimit, gjatë procesit të hetimit, shqyrtimit gjyqësor të personave në çështje penale, përfaqësimit të personave fizik ose juridik në çështjet civile dhe administrative në të gjitha Gjykatat, Arbitrazhi dhe në organe të tjera të Administratës Publike.
- ✚ Shërbime lidhur me zbatimin dhe ekzekutimin e vendimeve të Gjykatave.
- ✚ Ofrimin e konsulencës psikologjike, akteve të ekspertimit psikologjik e vlerësimit psikosocial, në organin procedues, në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore dhe ato të Apelit.
- ✚ Vlerësimin e dëmit psikologjik në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, Gjykatat e Apelit dhe Gjykatat Administrative.
- ✚ Veprime të tjera të ndihmës juridike dhe psikologjike që parashikon ligji.

KAPITALI




Kapitali themeltar i nënshkruar i Shoqërisë ka një vlerë prej 100.000 (një qind mijë) lekë.

NUMRI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR TË NËNSHKRUAR

Numri i pjesëve të kapitalit themeltar të nënshkruar është 2 (dy).

VLERA NOMINALE E SECILËS PJESË TË KAPITALIT THEMELTAR TË NËNSHKRUAR

Vlera nominale e secilës pjesë të kapitalit themeltar të nënshkruar është 50.000 (pesedhjetmije lekë.)

PJESMARRJA NË KAPITALIN THEMELTAR TË NËNSHKRUAR

Pjesmarrja në kapitalin themeltar të nënshkruar është 50% nga Z. Erion Spahiu dhe 50% nga Z.Elvin Dalti.

VLERA DHE LLOJI I KONTRIBUTIT TË ORTAKUT

Vlera e kontributit të ortakëve është 100.000 (një qind mijë lekë). Lloji i kontributit të ortakëve është në para, sipas parashikimit të nenit 68 pika 5 të Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Kapitali fillestar i nënshkruar është paguar nga ortakët në mënyrë të rregullt, plotësisht dhe rregullisht.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Asambleja e ortakëve organizon, drejton dhe kontrollon aktivitetin e Shoqërisë. Ortakët e Shoqërisë, është e detyrueshme të kenë profesionin e Avokatit dhe të mos kenë pengesë ligjore për ushtrimin e tij. Ortaku/ortakët e Shoqërisë përballojnë humbjen deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre.

Avokatët e ushtrojnë profesionin e tyre në emër të Studios Ligjore. Ata janë të detyruar të jenë Anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë në përputhje me ligjin Nr .9109,date 17.07.2003, i ndryshuar.

Avokatët anëtarë të Studios, gjatë ushtrimit të profesionit të tyre nuk mund të jenë njëkohësisht gjyqtar, prokuror, noter, nëpunës civil ose punonjës të administratës publike, si dhe të ushtrojnë funksione të tjera që janë të papajtueshme me ligjin.

Avokatëve të Studios u ndalohet të jenë edhe anëtarë të ndonjë zyre tjetër avokatie.



DISPOZITË E FUNDIT

Ndryshimet në Aktin e Themelimit mund të bëhen vetëm me shkresë dhe të miratuar nga Asambleja e Ortakëve. Pjese e pandarë e këtij akti është Statuti i Shoqërisë i cili nënshkruhet rregullisht nga themeluesit e Studios.

Ky Akt Themelimi u hartua në Tiranë në dt. 08.01.2018 në 3 kopje origjinale, i cili nënshkruhet rregullisht konform ligjit.

THEMELUES

ELVIN DALTI



ERION SPAHIU

